



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 10/12/2024

PROCES VERBAL

Konsultimi Publik mbi përmirësimin e Arsimit Parashkollor

Vendi : Qendra Kulturore Multifunkionale

Ora : 18:00

Tema e konsultimit : Përmirësimi i Shërbimit të Arsimit Parashkollor

I mbajtur sot më datë 10 Dhjetor në ambientet e Qendrës Kulturore Multifunkionale Përmet me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha dhe nën/Kryetares znj. Aulona Meshini. I pranishëm gjithashtu është z. Berti Kasi nga projekti Bashki të Forta. Në sallë ndodhen edukatorë dhe shumë prindër të interesuar për këtë takim.

Takimin e hapi nën/Kryetarja e Bashkisë znj. Aulona Meshini e cila përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falenderoi për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim mjaft të rëndësishëm për arsimin parashkollor. Më pas ajo vijoi të prezantoi një plan për përmirësimin e arsimit parashkollor. Ky plan u hartua në bashkëpunim me Bashki të Forta. Në fillim të prezantimit znj. Meshini dha informacione të përgjithshme lidhur me situatën e kopshteve dhe cerdheve në Bashkinë Përmet.

Më pas filloi të paraqiste më në detaje planin e ri duke filluar me masat që do të merren dhe ndryshimet që priten të ndodhin në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre. Gjithashtu ajo tregoi disa nga problematikat kryesore që hasin kopshtet në punën e tyre të përditshme dhe theksoi se nevojitet një bashkëpunim më i ngushtë midis edukatoreve dhe prindërve të femijëve. Po ashtu tha se janë bërë mjaft përmirësime në kopshte dhe cerdhe si dhe do të vijojë me rikonstrukcione për të rritur akoma dhe më shumë cilësinë e godinave të kopshteve.

Më pas fjalën e mori edhe znj. Alma Hoxha e cila theksoi edhe një herë se arsimit parashkollor mbetet një nga prioritetet e Bashkisë Përmet. Gjithashtu ajo u tha të pranishmëve se është bërë një punë e gjatë për hartimin e kësaj strategjie të re. Në vijim të fjalës së saj znj. Kryetare tha se ka nevojë për përmirësim në sistemin e arsimit parashkollor dhe sigurisht do të ketë një mbështetje të madhe për çdo familje dhe vecanerisht për familjet më në nevojë.

Pasi u prezantua i gjithë plani të gjithë të pranishmit ishin të qartë për mënyrën si do të veprohet në të ardhmen. Gjithashtu u konfirmua se do të ketë një bashkëpunim akoma më të madh mes edukatoreve dhe prindërve si e vetmja rrugë për të patur rezultate të kënaqshme në punën e tyre.

Në fund të takimit znj. Hoxha dhe znj. Meshini i falenderuan edhe një herë të gjithë pjesëmarrësit dhe u ritheksuan atyre edhe një herë se të tilla takime janë mjaft të rëndësishme për të njohur më nga afër problematikat e tyre dhe për të ecur më tej.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO

Foto nga takimi:

